



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 23.7b.1-2017-08**

## **RAPORTI I AUDITIMIT**

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË NDËRMARRJES  
PUBLIKE HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A PËR  
VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.a., në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme *Vlora Spanca*, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *udhëheqësja ekipit Ganimete Dalloshi dhe anëtarja ekipit Valmira Jonuzi*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Enver Boqolli*.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
5 Qeverisja.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	26
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme .....	29
Shtojca III: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit.....	35

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.a. për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 13/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar bazuar në cilësinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Trainkos-it.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Trainkos-it për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i kundërt

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryesuesi i Bordit nuk është pajtuar me të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e auditimit. Komentet e Kryesuesit të Bordit për çështjet për të cilat nuk jemi pajtuar, janë dhënë në detaje në Shtojcën III.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Trainkosit. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Trainkosit se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP-së).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. PFV-të përgatiten dhe nënshkruhen nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit ( ZKFTH) dhe Kryeshafi Ekzekutiv (KE) dhe dorëzohen për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimi

#### Opinion i kundërt

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Trainkosit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së pasasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese .

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kundërt, pasqyrat vjetore financiare nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të Trainkosit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit aktual të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

#### Baza për opinion të kundërt

1. Borxhet e pa arkëtueshme janë borxhe të cilat klientët ia kanë borxh biznesit dhe për të cilat vendosen se nuk do të paguhën kurrë. Ato fshihen nga librat si shpenzime dhe dërgohen në pasqyrën e të ardhurave. Llogaritë e arketueshme gjatë vitit 2017 ishin zvogëluar për 523,232€ të cilat ishin borxhe të vjetra të pa arkëtuara të cilat ndërmarrja i ka shpallur si borxh i keq. Mirëpo, me rastin e regjistrimit në kontabilitet këto borxhe nuk ishin regjistruar si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave, por ishte zvogëluar kapitali rezervë për atë shumë.
2. Investimet në vijim të prezantuara në bilancin e gjendjes ishin 247,164€, prej të cilave vetëm 100,568€ plotësojnë kriterin e njohjes si investim në vijim. Ndërsa, pjesa tjetër në vlerë

---

146,600€ janë investime të përfunduara të cilat është dashur të regjistrohen si pasuri jo qarkulluese.

3. Ndërmarrja nuk kishte bërë rivlerësim të pasurive jo qarkulluese edhe pse nga SNK 16 kërkohet që njëherë në 3 deri 5 vite të behet rivlerësimi i tyre. Kjo për shkak të vështirësive financiare.
4. Ndërmarrja në fund të vitit kishte bërë numërimin e stoqeve dhe kishte përgatitur raportin për numërim të stoqeve i cili nuk përputhet me shënimet kontabël. Me qëllim të korrigjimit të këtyre diferencave ndërmarrja ka shlyer nga regjistrat e saj stoqet të cilat realisht nuk ekzistojnë, mirëpo këtë korrigjim e kishte bërë duke e debituar kapitalin në shumën 96,732€.
5. Kapitali rezervë në fund të vitit 2016 kishte një saldo prej 5,003,218€, megjithatë ndërmarrja në vitin 2017 kishte bërë disa korrigjime të disa zërave financiar të vitit 2016 dhe mbylljes së llogarisë pezull, të cilat si kundër llogari kishin përdorur kapitalin rezervë me ç ‘rast saldo në fund të vitit 2016 ishte 5,330,438€. Po ashtu, gjatë vitit 2017, ky zë kishte pësuar ndryshime si pasojë e regjistrimit të borxheve të këqija në këtë llogari si dhe rregullimit të disa regjistrimeve të tjera.
6. Fitimi i vitit nuk paraqet rezultat të saktë financiar të ndërmarrjes kjo si pasojë e mos regjistrimit të shpenzimeve të borxheve të këqija në pasqyrën e të ardhurave në vlerë 523,232€.
7. Sipas SNK 7, një njësi ekonomike paraqet fluksin e mjeteve të saj monetare nga aktivitetet shfrytëzuese (operative), investuese dhe financuese në mënyrën që është më e përshtatshme për biznesin e saj. Trainkos tek aktivitetet investuese kishte prezantuar shumën 964,095€, mjete këto të cilat janë pranuar nga MZHE për investime kapitale dhe duhej kategorizuar tek aktivitetet financuese. Po ashtu, pagesat e bëra për aktivitetet operative në vlerë 80,564€, ishin prezantuar si pagesa për aktivitete investive.
8. Sipas SNK 20, grantet e marra për aktive të amortizueshme njihen si të ardhura gjatë periudhave në të cilat ngarkohet amortizimi për ato mjete. Trainkos në pasqyrën e të ardhurave tek të hyrat nga grantet përveç të hyrave nga grantet të cilat janë si rrjedhojë e amortizimit të aseteve të financuara nga grantet, kishte njohur edhe të hyrat nga subvencionet të cilat ishin pranuar nga MZHE për shpenzime operative në vlerë 72,622€.
9. Shënimet shpjeguese nuk japin informacione shpjeguese të plota dhe të sakta, për disa nga zërat e prezantuara në pasqyrat financiare, për më detaje shih nënkaptullin 3.6.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore dhe NP në Kosovë, ZKA është e pavarur nga Trainkosi dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kundërt.



---

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV**

Kryesuesi i Bordit të Trainkosit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit akrual sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Trainkosit.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik ( me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore; dhe
- Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përgatisë raportet si në vijim:
  - Statuti i NP-së;
  - Plani i Biznesit;
  - Raporte tremujore;
  - Raporte vjetore;
  - Raportin nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
  - Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Në draft PFV-të të datës 07/05/2018 ishin të nevojshme disa korrigjime financiare në bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe shënimet shpjeguese që ishin përcjellë me gabime materiale. Pas sugjerimeve tona për ti bërë veprimet e nevojshme, Trainkosi kishte bërë disa korrigjime, mirëpo nuk kishte arritur t'i eliminoj gabimet në tërësi. Si pasojë e kësaj ne kemi identifikuar të gjeturat të cilat i kemi prezantuar tek baza për opinion.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, PFV-të e përgatitura nga KE dhe ZKFTH me rastin e dorëzimit në BD, nuk mund të konsiderohen të sakta.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi 1** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kundërt. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet në pasqyrat financiare vjetore dhe për ta siguruar një pamje të drejte dhe të vërtetë të tyre.

Gjithashtu, Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve të vitit 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Trainkos. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Megjithatë, në shumë fusha gjatë hartimit të pasqyrave financiare vërehen mangësi të dukshme si: mos prezantim i saktë i pasurive jo qarkulluese, stoqeve, avanceve të dhëna, llogarive të pagueshme dhe obligimeve për tatime dhe kontribute.

Angazhimi i punonjësve për punë dhe detyra specifike për pozita të rregullta të punës si dhe pa zhvilluar ndonjë proces konkurrues, si dhe testimi i kandidatëve jo në harmoni me kërkesat ligjore, janë tregues që kontrollet e brendshme në menaxhimin e burimeve njerëzore kanë nevojë për përmirësim.

### 3.1 Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2017 (në €)**

Përshkrimi	Planifikimi fillestar	Plani përfundimtar	Realizimi 2017	Realizimi 2016
Të hyrat nga transporti i mallrave	1,266,000	1,030,000	842,835	589,146
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve	211,135	185,676	125,387	188,906
Të hyrat nga subvencionet e MZHE-së	500,000	500,000	744,814	500,000
Të hyrat nga subvencionet e MI -së	1,967,292	1,967,293	1,151,613	759,766
Të hyrat tjera	125,000	140,000	385,839 <sup>1</sup>	173,670
Të hyrat nga garantët për investime kapitale nga MZHE	1,000,000	1,000,000	891,480	939,804
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>5,069,427</b>	<b>4,822,969</b>	<b>4,141,968</b>	<b>3,151,292</b>
Shpenzimet për paga	1,873,500	1,781,000	1,674,841	1,769,155
Mallra dhe shërbime (përfshire edhe komunalit)	380,800	332,300	272,946	245,393
Kosto e shërbimit	1,675,010	1,645,500	1,151,853	1,338,142
<b>Gjithsej Shpenzimet</b>	<b>3,929,310</b>	<b>3,758,800</b>	<b>3,099,640</b>	<b>3,352,690</b>

Shpjegimet rreth ndryshimeve në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve janë dhënë si në vijim:

- Planifikimi fillestar i të hyrave nga shitjet/shërbimet dhe subvencionet ishte dukshëm më i lartë sesa plani përfundimtar. Megjithatë, në fund të vitit ndërmarrja kishte arritur të realizoj 86% të shumës së planifikuar. Tejkallim të shumës së planifikuar vërehet tek të hyrat nga subvencionet e MZHE-së ku shuma e planifikuar ishte tejkalluar për 49%. Kjo për shkak se MZHE përveç shumës së planifikuar në marrëveshjen për subvencionim në fund të vitit i kishte transferuar edhe 244,814€ për mbulimin e disa shpenzimeve që rrjedhin nga një kontekst gjyqësor të trashëguar nga ish Hekurudhat e UNMIK-ut. Po ashtu, si rezultat i transferimit të 268,526€ nga MZHE për mbulimin e disa shpenzimeve, shuma e planifikuar tek të hyrat tjera ishte tejkalluar për 176%. Megjithatë, shkallë më e ulët e realizimit në krahasim me planifikimin vërehet tek të hyrat nga subvencionet nga Ministria e Infrastrukturës ku plani ishte përmbushur vetëm 59% dhe tek të hyrat nga transporti i udhëtarëve, të cilat ishin realizuar vetëm 68%.

<sup>1</sup> Të hyrat tjera paraqesin: të hyrat nga shërbimet tjera 26,368€, të hyrat nga shitja e naftës për Infrakos 45,217, të hyrat nga dëmtimi i vagonëve dhe të tjera 45,727€ dhe të hyrat nga subvencionet nga MZHE 268,526€

- Sa i përket shpenzimeve, ndërmarrja ishte treguar më e kujdesshme në raport me vitin e kaluar. Shpenzimet e realizuara këtë vit në raport me planifikimin ishin 82%. Shpenzimet më të larta kishin ndodhur tek pagat, që në totalin e shpenzimeve marrin pjesë me 54%. Realizimi i tyre në raport me planifikimin ishte 94%. Sa i përket kostos së shërbimit rreth 37% e shpenzimeve kishin ndodhur për këtë kategori. Megjithatë në raport me vitin paraprak te kjo kategori kemi një kursim të buxhetit për 14%.

### Rekomandim

Nuk kemi rekomandim për këtë fushë.

## 3.2 Bilanci i gjendjes<sup>2</sup> (Pasqyra e pozitës financiare)

Ne kemi bërë auditimin e Bilancit të gjendjes, duke i testuar edhe gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

**Tabela 2: Bilanci i gjendjes së Trainkosit më 31 dhjetor 2017** (në €)

Pasuritë	Viti 2017	Viti 2016	Detyrimet dhe Ekuiteti	Viti 2017	Viti 2016
Toka, objektet, pajisjet dhe makineritë	6,108,772	5,794,005	Kapitali themelues	25,000	25,000
Investimet në vijim	247,165	698,539	Kapitali Rezervë	4,738,813	5,162,474
Stoqet	455,752	534,198	Fitimet/Humbjet e bartura	(1,102,387)	398,245
Llogaritë e arkëtueshme	1,329,087	1,515,446	Fitimi/Humbja e vitit	113,861	(1,500,632)
Parapagimi i TVSh-së	382,841	294,038	Obligimet afatgjata	3,933,999	3,965,552
Llogarite terja të arketueshme (avancet e dhëna)	23,489	23,489	Llogaritë e pagueshme	1,291,295	829,271
Paraja në bankë dhe arkë	695,291	51,047	Obligimet ndaj të punësuarve	3,953	1,721
			Obligimet për tatime dhe kontribute	225,212	29,131
			Obligimet e tatimit në fitim	12,651	
<b>Gjithsej:</b>	<b>9,242,397</b>	<b>8,910,762</b>		<b>9,242,397</b>	<b>8,910,762</b>

<sup>2</sup> SNK-t termin "Bilanci i Gjendjes" e kanë ndryshuar dhe emërtuar "Pasqyra e Pozitës Financiare", por derisa ndërmarrja e ka emërtuar bilanci i gjendjes edhe ne ju kemi referuar këtij emërtimi për të qenë konsistent me emërtimin e vet PFV-ve të cilat po i Auditojmë.

---

**Çështja 2 - Mos prezantim i saktë i pasurive jo qarkulluese**

- E gjetura** Shënimet e kontabilitetit duhet të jenë burim i besueshëm në hartimin e pasqyrave financiare. Megjithatë, kemi vërejtur mospërputhje ndërmjet tyre për zërat si në vijim: objektet, pajisjet dhe makineritë të prezantuara në bilancin e gjendjes ishin nënvlerësuar për 8,074€ (objektet, pajisjet ) dhe për 7,699€ (makineritë e prezantuara). Ky nënvlerësim, rrjedhë me qëllim të barazimit të bilancit të gjendjes.
- Rreziku** Mospërputhjet ndërmjet evidencave në kontabilitet dhe shumës së shifrave të prezantuara në pasqyra përveç se paraqesin pa saktësi të tyre, rrisin rrezikun e keqpërdorimit të pasurive jo qarkulluese.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është hartuar një listë e saktë e pasurive jo qarkulluese dhe se janë marrë veprimet e nevojshme për t'i korrigjuar pasqyrat financiare si dhe të siguroj se me rastin e hartimit të tyre, burim të jenë evidencat kontabël.

**Çështja 3 - Mos barazimet e gjendjes fizike të stoqeve me evidencat kontabël**

- E gjetura** Ndërmarrja në fund të vitit kishte bërë numërimin e stoqeve dhe kishte përgatitur raportin për inventarizim. Mirëpo, ky raport i inventarizimit nuk përputhet me evidencat kontabël, edhe përkundër që ndërmarrja kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për barazimin faktik të gjendjes së stoqeve sipas regjistrimit me evidencat kontabël. Kjo mospërputhje është një mbivlerësim në shumën 1,972€. Shkak për këtë ishin kontrollet jo efektive me rastin e barazimit të shënimeve kontabël me gjendjen faktike të stoqeve.
- Rreziku** Menaxhmenti i ndërmarrjes nuk ka pasqyrë të saktë për gjendjen e stoqeve, dhe si pasojë mund të bëj furnizime të panevojshme apo nuk do të jetë në gjendje t'i bëjë furnizimet e duhura për shkak të informacioneve të mangëta kontabël. Për më tepër, kjo rritë rrezikun e shmangies dhe keqpërdorimeve të stoqeve.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që bëhen barazimet e gjendjes së stoqeve në evidencat kontabël me gjendjen faktike të tyre si dhe të siguroj se janë shtuar kontrollet për përcjelljen e gjendjes së stoqeve dhe se po bëhen raportimet tek menaxhmenti në baza të rregullta periodike.

---

**Çështja 4 - Mos prezantim i saktë i llogarive tjera të arketueshme (avancet e dhëna)**

- E gjetura** Ndërmarrja, në PVF kishte prezantuar llogari tjera të arketueshme (avancet e dhëna) në vlerë 23,489€ ndërsa në shënimet kontabël vlera e kësaj llogarie është 26,893€. Për më tepër, kjo shumë e avanceve përmban edhe avance të dhëna që nga viti 2014, për të cilat nuk ishin marrë ende shërbimet/furnizimet në këmbim të kësaj vlere. Mos kujdesi i duhur me rastin e furnizimeve/shërbimeve dhe mungesa e funksionimit të kontrolleve të brendshme ka bërë që këto avance të mos shfrytëzohen nga viti 2014.
- Rreziku** Nënvlërësimi i zërave financiare ndikon në prezantim jo të saktë të pasqyrave financiare. Mos furnizimi me shërbime/furnizime për periodha të gjata kohore rritë rrezikun që ndërmarrja të mos mund ti realizoj të drejtat e saj për shkak të vjetërsisë së borxhit.
- Rekomandimi 4** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që me rastin e hartimit të PVF-ve zërat financiar të prezantojnë vlerë të saktë financiare. Po ashtu, të siguroj që në një afat sa më optimal për shumën e paguar si avancë janë realizuar shërbimet/furnizimet në këmbim të kësaj shume.

**Çështja 5 - Mos prezantim i saktë i llogarive të pagueshme**

- E gjetura** Llogaritë e pagueshme të prezantuara në bilancin e gjendjes nuk prezantojnë një gjendje të saktë të detyrimeve ndaj furnitorëve. Në krahasim me shënimet kontabël ato ishin nënvlërësuar për 26,893€. Për më tepër, në dy letër konfirmime të pranuar nga furnitorët janë vërejtur mospërputhje me shënimet kontabël. Nga një letër konfirmim të pranuar nga një furnitor vlera e borxhit të konfirmuar është 425€, ndërsa në shënimet kontabël vlera e detyrimit ndaj këtij furnitori ishte 644€. Ndërsa në një rast tjetër furnitori ka konfirmuar borxhin në vlerë 6,715€, ndërsa në shënimet kontabël kjo vlerë është 6,090€. Më tej, një borxh në vlerë 3,171€ nuk është korrigjuar nga viti i kaluar dhe vazhdon të figuroj në shënimet kontabël. Pasaktësitë lidhur me llogaritë e pagueshme, janë si rezultat i mos harmonizimeve të shënimeve kontabël me furnitorët.
- Rreziku** Mos mbajtja e shënimeve të sakta për llogaritë e pagueshme e rritë rrezikun që të bëhen pagesa më tepër ndaj furnitorëve apo edhe krijimin e kontesteve gjyqësore.
- Rekomandimi 5** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që në baza të rregullta mujore të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve ndaj furnitorëve dhe se zyrtarët përkatës raportojnë tek meneaxhmenti.



**Çështja 6 - Mos prezantim i saktë i obligimeve për tatime dhe kontribute**

**E gjetura** Obligimet për tatim në burim dhe kontribute të prezantuara në bilancin e gjendjes tregojnë një rritje në krahasim me vitin paraprak. Vlera e këtyre obligimeve ishte prezantuar 225,212€. Mirëpo, kjo shumë e prezantuar nuk pasqyron gjendjen reale për këto obligime. Kjo, pasi që, sipas raportit të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për gjendjen e borxheve të tatimpaguesit, shuma e obligimeve për tatime dhe kontribute ishte për 7,113€ më e ulët se shuma e prezantuar në bilancin e gjendjes. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos harmonizimit të shënimeve kontabël me shënimet në ATK.

Ndërmarrja nuk ka qenë subjekt i kontrollit nga ATK që nga themelimi saj.

**Rreziku** Mos prezantimi i saktë i obligimeve krijon pa saktësi të bilancit të gjendjes. Po ashtu, mungesa e evidencave të sakta lidhur me këto obligime rrezikon që ndërmarrja të paguaj me tepër se shuma e detyrimit.

**Rekomandimi 6** Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme, që shënimet kontabël të jenë në harmoni me gjendjen e borxheve në ATK dhe që obligimet të paguhen sipas afateve të parapara. Njëkohësisht, duhet të siguroj prezantim të saktë të zërave financiar.

### 3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Trainkos në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

**Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2017**

në€

Të hyrat	Viti 2017	Viti 2016
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	2,953,314	2,157,031
Të hyrat tjera	224,552	11,179
Të hyrat nga grantet	991,591	990,579
<b>Total të hyrat</b>	<b>4,169,457</b>	<b>3,158,788</b>
Kosto e shërbimit	1,151,853	1,238,149
Shpenzimet e pagave	1,674,841	1,761,366
Shpenzimet e zhvlerësimit	943,305	997,101
Shpenzimet operative dhe administrative	272,946	431,108
Të dala tjera të jashtëzakonshme	-	231,696
<b>Total shpenzimet</b>	<b>4,042,945</b>	<b>4,659,420</b>
<b>Fitimi/Humbja para tatimit</b>	<b>126,512</b>	<b>(1,500,631)</b>
Tatimi në fitim	12,651	-
<b>Fitimi/Humbja e pastër</b>	<b>113,861</b>	<b>(1,500,631)</b>

---

Ekzaminimet tona audituese lidhur me pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kanë rezultuar me gjetjet si në vijim:

---

#### **Çështja 7 - Njohja e të hyrave jo në pajtim me parimin akrual**

- E gjetura** Sipas parimit akrual të kontabilitetit, transaksionet dhe ngjarjet ekonomike njihen në momentin kur ndodhin e jo kur pranohet apo jepet paraja. Tek të hyrat nga transporti i udhëtarëve, në dy raste në shumën 4,364€, të hyrat e realizuara për shërbimin e dhënë në vitin e kaluar janë njohur si të hyra të këtij viti. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos deklarimit me kohë të kuponëve fiskal dhe raporteve të shitjes.
- Rreziku** Mos njohja e ngjarjeve dhe transaksioneve ekonomike në momentin që ndodhin rritë rrezikun që të hyrat e vitit përkatës të jenë të nënvlerësuar/ mbivlerësuar.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se raportet e shitjeve dorëzohen me kohë dhe se njohja dhe raportimi i të hyrave për periudhën përkatëse bëhet në momentin e ndodhjes dhe jo kur pranohet paraja.

#### **Çështja 8 - Mbivlerësimi i shpenzimeve të humbjes së naftës**

- E gjetura** Është kërkesë e SNK 1, që të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë një periudhe duhet të përfshihen në fitim ose humbje me përjashtim të rastit kur një Standard ose një Interpretim kërkon ndryshe. Ndërmarrja në pasqyrën e të ardhurave ka prezantuar shpenzimet për humbjet e naftës në vlerë prej 12,434€ nga të cilat 4,291€ i takojnë periudhës 2016. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos korrigjimit të shënimeve kontabël në periudhën përkatëse.
- Rreziku** Prezantimi i shpenzimeve të humbjeve të naftës, të periudhës paraprake, rezulton me mbivlerësim të shpenzimeve dhe respektivisht në nënvlerësim të rezultatit financiar.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që bëhen korrigjimet e nevojshme dhe po ashtu, që shpenzimet të njihen në momentin që ndodhin, respektivisht në periudhën që janë shkaktuar.

---

**Çështja 9 - Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore****E gjetura**

Gjatë auditimit të kësaj kategorie janë evidentuar mangësitë si në vijim:

- Bazuar në Ligjin e Punës, çdo punëdhënës në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punonjës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Deri në qershor 2017, Trainkosi kishte pranuar katër punëtor për pune dhe detyra specifike të cilët mbulonin pozitat e rregullta të punës dhe për të cilët nuk kishte zhvilluar procedura të rekrutimit. Megjithatë pas pranimit të raportit tonë të vitit 2016 nuk kishte raste të tilla.
- Udhëzimi Administrativ nr. 14/2011 për Marrëdhënie të Punës me rastin e procesit të rekrutimit, përcakton se testi me shkrim duhet të përbëhet nga tri pjesë me një numër të përcaktuar pikësh për secilën prej tyre: pjesa e njohurive të përgjithshme, pjesa e pyetjeve të aftësive të përgjithshme dhe personaliteti, si dhe pjesa me pyetje që lidhen me vendin e punë. Ne kemi vërejtur se në tri procese të rekrutimit testimi i kandidatëve ishte i hartuar vetëm me pyetje që kanë të bëjnë me vendin e punës. Kjo për shkak të kontroleve të brendshme jo funksionale dhe mbikëqyrjes jo adekuate të menaxhmentit ndaj komisionit për rekrutim.

**Rreziku**

Dobësitë e paraqitura në procesin e rekrutimit të personelit, respektivisht testimi i kandidatëve vetëm me pyetjet në lidhje me vendin e punës dhe angazhimi i punonjësve të përcaktuar për punë dhe detyra specifike në pozita të rregullta të punës pa zhvilluar ndonjë proces konkurrues, përveç që është në kundërshtim me rregulloren në fuqi, rrit rrezikun në përzgjedhjen e personelit jo të duhur e cila mund të reflektoj në performancën e organizatës në përgjithësi.

**Rekomandimi 9**

Kryesuesi i Bordit duhet të shqyrtojë mangësitë e identifikuar dhe të marrë masat e nevojshme që angazhimi i punonjësve për punë dhe detyra specifike dhe hartimi i testit të bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi. .

### 3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të ndërmarrjes, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

**Tabela 4: Kapitali i Trainkos-it më 31.12.2017**

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>KAPITALI</b>	<b>3,775,287</b>	<b>4,085,087</b>
Kapitali themeltar	25,000	25,000
Kapitali rezervë	4,738,813	5,162,474
Fitimet/Humbjet e bartura	(1,102,387)	398,245
Fitimet/Humbja e vitit aktual	113,861	(1,500,632)

Mangësitë lidhur me prezantimin e kapitalit janë prezantuar tek baza për opinion.

### 3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

**Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme**

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>Paratë neto nga aktivitetet operative</b>	<b>415,918</b>	<b>(2,807,979)</b>
Arkëtimet e parasë nga blerësit	3,026,152	657,228
Arkëtimet e parasë nga sigurimi për kompensim dëmi	6,831	
Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet operative	195,904	
Pagesat e parasë për furnitorët	(1,314,864)	(1,505,426)
Pagesat e parasë për të punësuarit	(1,418,622)	(1,728,085)
Pagesat e parasë për tatime	(64,706)	
Pagesat e tjera të parasë për aktivitetet operative	(14,777)	(231,696)
<b>Paratë neto nga aktivitetet investive</b>	<b>228,326</b>	<b>(998,969)</b>
Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet investuese	964,095	
Pagesat tjera të parasë nga aktivitetet investuese	(735,770)	(998,869)
<b>Paratë neto nga aktivitetet financuese</b>		<b>2,031,959</b>
Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet financuese		2,031,959
<b>Rritja /zvogëlimi i parasë gjatë vitit</b>	<b>644,244</b>	<b>(1,774,989)</b>
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	51,047	1,826,036
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit</b>	<b>695,291</b>	<b>51,047</b>

---

Mangësitë lidhur me prezantimin e rrjedhës së parasë së gatshme janë prezantuar tek baza për opinion.

### 3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në Bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

---

#### Çështja 10 - Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese

**E gjetura** Shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë i pasqyrave financiare duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese.

Gjatë analizës së shënimeve shpjeguese janë identifikuar dobësitë si në vijim:

- Nuk ishin shpalosur informacione për investimet në vijim të prezantuara në bilancin e gjendjes;
- Nuk ishin shpalosur informacione për zërat e pasqyrës së rrjedhës së parasë;
- Nuk ishin shpalosur informacione për pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet; dhe
- Shënimet shpjeguese për: pasuritë jo qarkulluese, stoqet, avancet, llogaritë e pagueshme dhe obligimet për tatime dhe kontribute nuk prezantojnë informacion të saktë.

Mangësitë e identifikuar më lartë, janë si rrjedhojë e kontrolleve jo efektive me rastin e hartimit të PFV-ve.

**Rreziku** Prezantimi jo i plotë dhe mangësitë e informacioneve në shënimet shpjeguese, ndikojnë në cilësinë e pasqyrave financiare, paqartësinë e shifrave të prezantuara si dhe kufizojnë përdoruesit e pasqyrave për ta kuptuar gjendjen e drejtë dhe të vërtetë të rezultateve financiare dhe afariste të ndërmarrjes.

**Rekomandimi 10** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve, shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2016 të Trainkos-it ka rezultuar në 19 rekomandime kryesore. Trainkos kishte përgatitur një Plan Veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Krahasuar me vitin e kaluar, vërehet një qasje më serioze dhe angazhim më i lartë në adresimin e çështjeve dhe rekomandimeve të dala në raportin e kaluar të auditimit, ku rreth 74% prej tyre janë zbatuar apo janë në proces e sipër. Deri në fund të auditimit tonë, zbatueshmëria e rekomandimeve për vitin 2016 ishte si në vijim: 7 (shtatë) rekomandime janë zbatuar, 7 (shtatë) ishin në proces të zbatimit si dhe 5 (pesë) nuk janë zbatuar ende.

Ndërsa, nga viti 2015 nga gjashtë rekomandimet e dhëna nga auditori i jashtëm vetëm një prej tyre nuk ishte zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

---

### Çështja 11 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** Me gjithë progresin e treguar në zbatimin e rekomandimeve, shumica e rekomandimeve të pa zbatuara ndërlidhen me fushat të cilat kanë ndikuar në opinionin të auditimit, si: llogaritë e arkëtueshme, pasuritë jo qarkulluese, kapitali rezervë dhe shënimet shpjeguese.
- Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve e sidomos të atyre të cilat kanë ndikuar në opinionin e auditimit në vitin paraprak, mund të rezultojë me modifikim të opinionit edhe në raportin e auditimit për vitin vijues. Ndërsa, mos zbatimi i rekomandimeve tjera rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta, të cilat mund të ndikojnë si dobësi në menaxhimin financiar dhe të kontrolleve.
- Rekomandimi 11** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve është duke u monitoruar rregullisht dhe se po zbatohet në përputhje me afatet e përcaktuara kohore. Në fokus parësor duhet të jenë rekomandimet që kanë ndikim në opinion dhe që prekin fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

## 5 Qeverisja

### Hyrje

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Trainkos në përgjithësi ka kontrollë të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Në raport me vitin paraprak, menaxhmenti i sajë ka bërë përmirësime të dukshme në qeverisjen e mirë. Ne vlerësojmë progresin e bërë në hartimin e planit për menaxhimin e rreziqeve si dhe rishikimin e planit të biznesit sipas kërkesave ligjore.

Megjithatë, për të mbështetur një menaxhim efektiv të ndërmarrjes, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen edhe më tej si: funksionalizimi i njësisë së auditimit të brendshëm dhe ndarja e qartë e detyrave sipas strukturës organizative.

---

## 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur për të ofruar siguri objektive dhe një aktivitet këshillues, i dizajnuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e ndërmarrjes. Po ashtu, ndihmon ndërmarrjen për përmbushjen e objektivave, duke nxitur një qasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit në menaxhimin e rrezikut, kontrolleve dhe proceseve të qeverisjes.

---

### Çështja 12 - Mos funksionimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

**E gjetura** Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) nga muaji mars 2017 ishte pa zyrtar të auditimit të brendshëm, për shkak të dorëheqjes së tij. Ndërmarrja gjatë vitit 2017 kishte shpallur tri herë konkurs për plotësimin e pozitës për auditor të brendshëm. Në rastin e parë kishte dështuar për mungesë të kandidatëve të kualifikuar sipas kërkesave të konkursit. Pastaj në dy rastet tjera nuk kishte arritur të plotësoj këtë pozitë për shkak të komisionit jo të plotë të auditimit, i cili nga data 21.09.2017 (kur Kryesuesi kishte dhënë dorëheqje) ishte mbete me vetëm dy anëtarë. Megjithatë, edhe pas plotësimit të komisionit të auditimit kjo pozitë ende nuk ishte plotësuar (deri në përfundim të auditimit, datë 01.06.2018).

**Rreziku** Mos funksionimi i NJAB-së rritë rrezikun që për shkak të kompleksitetit dhe madhësisë së ndërmarrjes, menaxherët e lartë të kenë vështirësi të kontrollojnë proceset dhe veprimtarinë e saj në mënyrë efektive. Kjo mund të rezultojë me dobësi të pidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që mund të përfundojnë kontrolle të dobëta dhe me humbje financiare për ndërmarrjen.

**Rekomandimi 12** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj funksionimin e ndërmarrjes në mënyrë efektive dhe për këtë duhet ta përzgjedh zyrtarin e auditimit të brendshëm sipas kërkesave ligjore, për të ndihmuar menaxhmentin lidhur me vlerësimin e kontrolleve të brendshme në ndërmarrje.

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe manaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpallje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, manaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Pas rekomandimeve tona, menaxhmenti i ndërmarrjes kishte ndërmarre veprimet e nevojshme duke siguruar hartimin e planit për menaxhimin e rreziqeve si dhe rishikimin dhe plotësimin e përmbajtjes së planit të biznesit me të gjitha kërkesat ligjore.



---

Ndërmarrja ka zbatuar një sërë kontrollesh që përfshijnë udhëheqjen dhe organizimin e aktiviteteve operacionale. Ndërkohë që kontrollet në disa fusha kanë funksionuar relativisht mirë, parregullsi janë hasur në ndarjen e detyrave.

---

### Çështja 13 - Ndarje jo e duhur e detyrave

- E gjetura** Trainkos ka të vendosur strukturën e saj organizative, mirëpo nuk kishte bërë ndarje të qartë të detyrave. Është kërkesë e rregullores për menaxhimin e pasurive jo qarkulluese (neni 4.7) që ndërmarrja të caktoj një zyrtar të pasurisë apo detyrat e zyrtarit të pasurisë mund të jenë vetëm një pjesë e punës së plotë në ndërmarrje. Trainkos përveç se nuk kishte një zyrtar të pasurisë, nuk ka siguruar ndarje të duhur të detyrave dhe qartësimin e përgjegjësive të deleguara lidhur me detyrat e zyrtarit të pasurisë. Detyrat e zyrtarit të pasurive i kryente zyrtari i financave. Mungesa e zyrtarit të pasurisë është për shkak të emërimit të zyrtarit paraprak të pasurisë si zyrtar certifikues.
- Rreziku** Autorizimi dhe ndarja jo e duhur e detyrave dhe përgjegjësive redukton kontrollin efektiv dhe aftësinë e menaxhmentit për të administruar në mënyrë efektive me pasuritë jo qarkulluese. Më tutje, kjo rrezikon edhe humbjen e tyre dhe prezantimin e pasqyrave financiare me pasaktësi.
- Rekomandimi 13** Kryesuesi i Bordit duhet të bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese për ndarje të duhur të detyrave për menaxhimin e pasurive jo qarkulluese.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1. Pasqyrat Financiare - Aktiva	Auditori ju rekomandon që kompania të krijoj evidencën e duhur dhe të plotë për secilin aset veç e veç duke përfshirë këtu edhe gjitha shpenzimet e ndodhura për riparimin apo mirëmbajtjen domethënëse në mënyre që në çdo kohë të kemi një pasqyrim të plotë dhe objektiv për secilin aset veç e veç.	Është zbatuar.		
2. Pasqyra e pozicionit financiar - Aktiva	Auditori ju rekomandon që të bëni barazimet me të shpeshta me klientët e juaj dhe të harmonizoni shënimet në mënyre që vlerat të përputhen në tërësi. Minimalisht para mbylljes së pasqyrave financiare duhet të i harmonizoni shënimet tuaja me vlerat që rezultojnë në evidencat kontabël të klientëve tuaj.	Është zbatuar.		
3. Pasqyra e pozicionit financiar - Pasiva- Kapitali Aksionar	Gjatë procesit të auditimit janë vërejtur zërat e kapitalit themeltar dhe ato të fitimeve të grumbulluara dhe të pa sistemuara nuk pasqyrohen si të ndara por grumbullohen në një konto të vetme me emërtimin “ Bilanci i çeljes “ me çast nuk shihet ecuria e rezultateve financiare të kompanisë në perspektiv. Kjo gjetje ishte vërejtur edhe në pasqyrat e vitit 2014 dhe rekomandimi i auditorit mbetet akoma në fuqi.	Është zbatuar.		

4. Pasqyra e pozicionit financiar - Pasiva- Të pagueshmet tjera dhe tregtare	Auditori ju rekomandon se pasi të përmbyllni pasqyrat financiare në fund të periudhës raportuese zërat e të arkëtueshmeve të tjera tregtare si dhe të pagueshmeve tjera dhe tregtare të trajtohen sipas raportit obligim apo kërkesë dhe jo sipas klasës apo grupit të kontove. (Sqarim shtesë) Nëse një blerës ka bërë parapagim të trajtohet si obligim ndaj blerësit e jo të thyhet me vlerën e blerësve tjerë ndaj të cilave kompania ka kërkesa, e njëjta vlen edhe për furnitorët.	Është zbatuar.		
5. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirë se	Gjatë procesit të auditimit kemi hasë në mospajtimin e pohimeve nga burimet e ndryshme për sa ju perkat ‘Të hyrave gjithëpërfshirëse të kompanisë’ nga se pohimet për të hyrat në bilancin vërtetues respektivisht në “Pasqyrave e të ardhurave gjithëpërfshirëse “nuk korrespondon në plotësi me të hyrat nga deklaratat tatimore të TVSh-së, po e njëjta dukuri është vërejtur edhe nga pohimet e shpenzimeve operative të pasqyruara në B.V, respektivisht në P.A.GJ.P. që nuk korrespondojnë në plotësi me shënimet e blerjeve e të cilat i përkasin shpenzimeve operative të kompanisë, dhe të cilat janë pasqyruar me deklaratat tatimore për TVSh-në. Kjo gjetje ishte vërejte edhe gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2014 andaj rekomandimi i auditorit mbetet po i njëjti.	Është zbatuar.		
6. Blerja përmes aplikimit të procedurave minimale	Autoriteti kontraktues duhet të shmang përdorimin e shpeshtë të procedurave minimale dhe të përdorë procedurat e hapura, me qëllim të trajtimit të barabartë, të nxitjes së konkurrencës dhe të arrihet cilësia sipas parimit vlera për para.			Nuk është zbatuar

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.Pasqyrat Financiare	1. Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kundërt. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet në pasqyrat financiare vjetore dhe për ta siguruar një pamje të drejte dhe të vërtetë të tyre.			Nuk është zbatuar, vazhdojnë të ekzistojnë gabime materiale edhe në PFV të vitit 2017.
	2. Kryesuesi i Bordit gjithashtu duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. PFV-të duhet të aprovohen nëse ndaj draft të tyre janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			Nuk është zbatuar.
Qeverisja e mirë	3. Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë zbatimin e planit të veprimit, i cili i përcakton afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Jashtëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të vitit paraprak duhet të shqyrtohen me drejtorët relevant dhe të raportohen tek Kryeshefi Ekzekutiv.		Nga gjashtë rekomandimet e dhëna në vitin 2015, vetëm një prej tyre nuk ishte zbatuar.	
	4.Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që plani i biznesit, krahas synimeve afariste dhe qasjes për realizimin e tyre të përmbajë edhe afatet kohore për realizimin e tyre.	Është zbatuar.		

	5. Kryesuesi i Bordit duhet të shqyrtojë shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në fushat e cekura më lartë dhe të sigurojë eliminimin e tyre në mënyrë që të përmirësojë këto dobësi.		Menaxhmenti i ndërmarrjes kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme lidhur me forcimin e kontrolleve. Megjithatë në disa fusha kontrollet nuk ishin efektive.	
Auditimi i Brendshëm	6. Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të sigurojë që Komiteti i Auditimit të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm, realizimin e planit, rezultatet dhe cilësinë e raporteve të auditimit. Gjithashtu, duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm			Nuk është zbatuar. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në Traikos nga muaji mars 2017, nuk është funksionale. Kjo, për shkak të dorëheqjes së Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm.
Kosto e shërbimit	7. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të sigurojë që në kuadër të kostos së shërbimit të përfshihen vetëm ato shpenzime të cilat janë të lidhura me koston e shërbimit, ndërsa shpenzimet tjera të njihen si shpenzime të periudhës.	Është zbatuar.		
Të hyrat	8. Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që realizimi i të hyrave monitorohet në mënyrë sistematike dhe ndryshimet apo devijimet nga planet fillestare reflektohen në planin e të hyrave.	Është zbatuar.		
	9. Kryesuesi i Bordit duhet të marrë masa në mënyrë që të sigurojë që regjistrimi i të hyrave behet me kohë, të mbajë një regjistër lidhur me faturat e paguara dhe ato të papaguara nga klientët dhe në rast të vonesave të pagesave nga klientët të aplikojë ndëshkimet.			Nuk është zbatuar.



Paga dhe mëditje	10. Kryesuesi i Bordit duhet të shqyrtojë mangësitë e identifikuarra dhe të marrë masat e nevojshme që të respektohen dispozitat ligjore përkatëse me rastin e angazhimeve të stafit të ri, gjithashtu pozitat me përgjegjësi operationale duhet të ushtrohen nga zyrtarët/punonjësit me kontrata të rregullta të punës.		Një pjese e të gjeturave që ndërlidhen me këtë rekomandim ende nuk është zbatuar.	
Shpenzimet	11. Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë rritjen e kontrolleve në mënyrë që të gjitha shpenzimet të verifikohen dhe aprovohen nga Zyrtari Certifikues, para regjistrimit në sistemin e kontabilitetit.	Është zbatuar.		
	12. Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që zyrtari certifikues të verifikoj shpenzimet sipas kontratës dhe për pjesën e paguar më tepër të kërkoj që të kthehen në buxhetin e ndërmarrjes.	Është zbatuar.		
	13. Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj masat e duhura për respektimin e rregullave të prokurimit publik dhe të ushtrojë mbikëqyrje të përshtatshme për menaxhim.	Është zbatuar.		
Pasuritë jo qarkulluese	14. Kryesuesi i Bordit duhet të nxjerr një rregullore të brendshme që përcakton procedurat standarde për menaxhim të pasurive jo qarkulluese dhe të sigurojë që pasuritë të trajtohen sipas SNK-ve dhe rregullave në fuqi, duke prezantuar vlerën e saktë të tyre në PFV.		Ndërmarrja ka hartuar rregulloren për menaxhim të pasurive, mirëpo vlera e pasurive e prezantuar në PFV nuk ishte e sakte.	
Pasuritë qarkulluese	15. Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se kërkesat për financimin e udhëtimeve zyrtare vlerësohen sipas rregulloreve në fuqi dhe të financohen vetëm kur plotësohen kriteret e duhura.	Është zbatuar.		

Ekuiteti	16. Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që të bëhen korrigjimet e nevojshme duke vendosur një mekanizëm rishikues për të konfirmuar saktësinë e shumave të regjistruara në kontabilitet dhe të njëjtat të prezantohen në PFV.		Fitimet e mbajtur ishin korrigjuar, mirëpo kapitali rezerve nuk është korrigjuar.	
	17. Kryesuesi i Bordit dhe Kryeshefi Ekzekutiv, duhet të hartojnë një plan strategjik të qëndrueshmërisë dhe të përmirësimit të biznesit i cili duhet të jetë i detyrueshëm në praktikë.		Ndërmarrja nuk ka hartuar ndonjë plan strategjik edhe pse këtë vit ka operuar me fitim.	
LLP	18. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të sigurojë që të bëhet harmonizimi i shënimeve kontabël me furnitorët, ndërsa vlerat negative të trajtohen dhe regjistrohen në regjistra kontabël adekuat.			Nuk është zbatuar.
Shënimet shpjeguese	19. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të sigurojë se gjatë hartimit të PFV-ve të prezantohen në shënimet shpjeguese informacione të detajuara, të plota dhe të sakta për secilin zë të pasqyrave financiare.		Shënimet shpjeguese këtë vit ishin me të plota, mirëpo janë identifikuar disa mangësi.	

## Shtojca III: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e NP-së në rast të mospajtimit	Pikëpamjet e ZKA-së
<b>Baza për opinion- Pika 1.</b>	Jo	<p>Në bazë të rekomandimeve të auditimit nga viti paraprak që pasqyrat financiare të paraqesin një gjendje sa më reale ne kemi përgatitur planin e veprimit dhe kemi ndërmarr hapat konkret lidhur me të arkëtueshmet. Shuma e të arkëtueshmeve prej 523,232€ i përket periudhës 2002-2011 të bartura nga raporti i ndarjes së Hekurudhave të Kosovës. Këto borxhe për shkak të vjetërsisë nuk i plotësojnë kriteret ligjore për borxh të keq sipas kuptimit të Ligjit Nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe si të tilla nuk është lejuar nga ATK që të regjistrohen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave, prandaj kemi vendosur që këto të debitohen në kapital të ndërmarrjes. Këto borxhe nuk janë falur dhe në vazhdimësi nga stafi i ndërmarrjes kërkohet që të synohet në arkëtimin e tyre.</p> <p>Sipas nën paragrafit 3.4 të nenit 12 të Ligjit Nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, nëse një shumë e caktuar nuk është arkëtuar brenda periudhës 24 mujore nga data e obligimit për pagesë, atëherë nuk mund të konsiderohet si borxh i keq, citojmë:</p> <p><i>“3. Shuma e paarkëtuar nuk do të konsiderohet borxh i keq nëse:</i></p> <p><i>3.1. transaksionet me të njëjtin borxhli janë përsëritur pas shpalljes së borxhit të keq, me përjashtim të shërbimeve publike;</i></p> <p><i>3.2. borxhi i keq është ndërmjet palëve të lidhura;</i></p>	<p>Pasqyrat vjetore financiare duhet të përgatiten sipas Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar. Siç ka përcaktuar Ligji 04/L-014 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim. Trainkos borxhet e këqija në rastin e regjistrimit në kontabilitet i kishte regjistruar jo në pajtim me kërkesat e standardeve të lartpërmendura. Ndërsa kërkesat e përcaktuara nga ATK lidhur me borxhet e këqija vlejné vetëm për qëllime tatimore, por jo edhe për qëllime të raportimit financiar.</p> <p>E gjetura dhe rekomandimi i auditorit qëndron.</p>

		<p>3.3. nuk ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të vjelë borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit;</p> <p><u>3.4. kanë kaluar mbi njëzet e katër muaj (24) muaj nga data e obligimit për pagesë."</u></p> <p>Sipas përkufizimit ligjor të dhënë më sipër, derisa borxhet i takojnë periudhës 2002-2011, atëherë nuk mund të konsiderohen si borxhe të këqija dhe si të tilla nuk njihen në Pasqyrën e të Ardhurave si shpenzim.</p>	
<b>Baza për opinion- Pika 4.</b>	Jo	<p>Diferenca e stoqeve ka qenë pasojë e regjistrimit jo të saktë në raportin e ndarjes të Hekurudhave të Kosovës ku si e tillë është bartur nga viti 2011 deri në vitin 2016. Pas regjistrimit të stoqeve (ku përfshihen edhe pjesët rezervë) për vitin 2016 ne e kemi vërejtur që diferenca në vlerë prej 96,732 ka qenë vlerë që duhet fshirë sepse nuk ekzistojnë dhe nuk kemi argumente që ne i kemi në posedim këto stoqe me këtë vlerë. Stoqet bëjnë pjesë në pasuritë qarkulluese në Pasqyrën e Pozitës Financiare (Bilanci i Gjendjes) në pozitën e pasurisë dhe si të tilla varësisht prej vlerës së stokut sa më e madhe që ajo është tregon edhe kapitalin më të madh të ndërmarrjes dhe e kundërta. Prandaj ne këtë vlerë të stoqeve e kemi zbritur prej (e kemi debituar me kapitalin) kapitalit për të dhënë një pasqyrë reale të pasurisë/kapitalit të ndërmarrjes e jo të futet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave një shpenzim që nuk ekziston.</p>	<p>Në rastin e konstatimit të diferencave të stokut në mes të depos dhe shënimeve kontabël, këto diferenca në kontabilitet duhet të njihen si shpenzime dhe nuk lejohet që të mbyllen me kapital.</p> <p>Andaj e gjetura dhe rekomandimi i Auditorit qëndron.</p>
<b>Baza për opinion- Pika 6.</b>		<p>Fitimi është rezultat i saktë financiar dhe ne në pikën 1 të kësaj shtojce kemi sqaruar se: sipas nën paragrafit 3.4 të nenit 12 të Ligjit Nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, sqaron që borxhet më të vjetra se dy vite nuk konsiderohen borxhe të këqija dhe si të tilla nuk mund të përfshihen në pasqyrat e të ardhurave si shpenzime.</p>	<p>Pasqyrat vjetore financiare duhet të përgatiten sipas Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar. Siç ka përcaktuar Ligji 04/L-014 për kontabilitet, raportim financiar</p>

---

			<p>dhe auditim. Trainkos fitimin e vitit e kishte të mbivlerësuar për shkak të mos njohjes së borxheve të këqija si shpenzime. Ndërsa kërkesat e përcaktuara nga ATK lidhur me borxhet e këqija vlejné vetëm për qëllime tatimore, por jo edhe për qëllime të raportimit financiar.</p> <p>E gjetura dhe rekomandimi i auditorit qëndron.</p>
--	--	--	---